

NJOFTIM

**MBI APLIKIMIN E APLIKUESIT “ALB GREEN ELECTRICITY” SH.P.K., PËR
NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “SOPOTI” ME KAPACITET PRODHUES
DERI NË 2 MW, NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË PËRROIT TË
SOPOTIT, ME DERDHJE NË LUMIN GOSTIMË,
BASHKIA LIBRAZH, QARKU ELBASAN**

Në përputhje me Ligjin nr.43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe VKM nr. 822 datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, Aplikuesi “Alb Green Electricity” sh.p.k., ka aplikuar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për miratimin e ndërtimit të hidrocentralit “Sopoti”, me kapacitet prodhues deri në 2 MW, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Sopotit, me derdhje në lumin Gostimë, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.

- Shoqëria “Alb Green Electricity” sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me objekt të aktivitetit: Studim-projektimi i njësive gjeneruese hidroenergjitike që do të jenë në pronësi të shoqërisë; Studim-projektimi i linjave të tensionit të lartë, mesëm dhe të ulët, projektzbatimi si dhe ndjekja përkatëse e punimeve për njësitë gjeneruese hidroenergjitike që do të jenë në pronësi të shoqërisë; Studim-projektimi i kabinave të ndryshme elektrike të linjave të tensionit të lartë, mesëm dhe të ulët, projekt-zbatimi si dhe ndjekja përkatëse e punimeve për njësitë gjeneruese hidroenergjitike që do të jenë në pronësi të shoqërisë; Përdorimi i sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe i pajisjeve transformuese e kontrolluese për shpërndarjen e energjisë elektrike për njësitë gjeneruese hidroenergjitike që do të jenë në pronësi të shoqërisë; Ndërtimi i njësive të reja gjeneruese hidroenergjetike që do të jenë në pronësi të shoqërisë; Operimi i njësive të reja gjeneruese hidroenergjetike që do të jenë në pronësi të shoqërisë; Tregtimi i të gjitha pjesëve, aggregateve dhe paisjeve që realizojnë prodhimin e energjisë elektrike si dhe materialeve si vajra, lubrifikante, karburante dhe derivatet e hidrokarbureve, për njësitë gjeneruese që do të jenë në pronësi të shoqërisë; Tregtia e energjisë elektrike, përfshirë dhe pa u limituar në, shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar të aplikueshëm, për njësitë gjeneruese hidroenergjitike që do të jenë në pronësi të shoqërisë. Tregtia e energjisë elektrike mund të zhvillohet në territorin e Shqipërisë ose jashtë tij, në përputhje me nevojat e shoqërisë; Pjesëmarrja në ankandet për alokimin e të drejtave të transmetimit (PTR-s), sic zhvillohen në Shqipëri ose jashtë saj, për të tregtuar, kryesisht, energjinë elektrike që do të prodhohet nga njësitë gjeneruese që do të jenë në pronësi të shoqërisë; Pjesëmarrja në bursat e energjisë të themeluara në rajon si dhe bursën

përkatëse shqipëtare (kur dhe në rast se themelohet), për të tregtuar, kryesisht, energjinë elektrike që do të prodhohet nga njësitë gjeneruese që do të jenë në pronësi të shoqërisë; Furnizimi me energji elektrike i të gjithë konsumatoreve fundore në Shqipëri, përfshirë konsumatorët e lidhur në tensionin e ulet, te mesem dhe te larte, me baze, kryesisht, energjine elektrike që do të prodhohet nga njësitë gjeneruese që do të jenë në pronësi të shoqërisë; Themelimin e grupit të saj balancues ose pjesëmarrja në grupin balancues të shoqërive të tjera; Të marrë hua për investime si dhe financim asetesh për njësitë gjeneruese hidroenergjitike që do të jenë në pronësi të shoqërisë;

Një informacion më i detajuar lidhur me projektin mund të gjendet pranë Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit në Ministrinë e Infrastruktues dhe Energjisë.

Objeksionet ose komentet lidhur me këtë aplikim mund të dërgohen në adresën e mëposhtme brenda 15 ditësh nga data e publikimit të parë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit

Blvd. Dëshmorët e Kombit, 1001

Tiranë